



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK DHE BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2922/Prot.
/1

Tiranë, më 14.12.2018

VENDIM I PËRBASHKËT

Nr. 42, datë 14.12.2018

**“MBI KËRKESAT E KËSHILLAVE STUDENTORË, UNIVERSITETI I MJEKËSISË,
TIRANË”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe të kërkesave të Këshillit Studentor të Fakultetit të Mjekësisë dhe të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë përkatësisht me nr. 2899 prot, datë 11.12.2018, nr. 2908 prot, datë 12.12.2018, nr. 2899/1 prot, datë 13.12.2018, pas diskutimeve në mbledhjet e datës 11 dhe 14 dhjetor 2018, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSËN:

Lidhur me aspektin financiar:

1. Të mbështesin kërkesën e studentëve për përgjysmimin e tarifave të studimit. Nisur nga vlerësimi i treguesve të buxhetit të vitit akademik 2018-2019, vlerësojnë se efekti financiar që vjen nga ky reduktim duhet të mbulohet tërësisht nga granti i buxhetit të shtetit, pasi në të kundërt përgjysmimi i tarifave të studimeve, përballuar vetëm nga fondet e Universitetit do të rrezikonte qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe do të ndikonte negativisht në cilësinë akademike.
2. Heqjen e tarifave të shërbimeve për studentët **aktiv**:
 - Vërtetim studenti
 - Listë notash e pjeshme, e plotë.
 - Karton diplome
 - Supplement diplome (cikli i parë dhe i dytë)
 - Librezë notash, librezë praktikash.

3. Të kërkojnë që dekanatet të rishikojnë fondet për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe reflektimin e ndryshimeve në buxhetin e vitit 2019.
4. Mbështetjen e kërkesës së studentëve për dyfishimin e buxhetit të UMT-së nga granti i buxhetit të shtetit.
5. Të miratojnë kërkesën, që në raste të veçanta, me kërkesë të Këshillit Studentor të fakultetit përkatës apo të njëjve kryesore, mund të shtyhen afatet e aplikimit për përjashtim nga tarifat.
6. Mbështetjen e kërkesës së studentëve që bëhet transparent çdo veprimtari financiare duke pasqyruar dhe në faqen zyrtare të universitetit.
7. Të kërkojnë që fakultetet të pajisin studentët me mjet identifikimi (badge), brenda tre muajve.
8. Të kërkojnë që çdo fakultet të bëjë një analizë të plotë të kostove financiare për çdo program studimi dhe t'i paraqesë ato për vlerësim në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit.
9. Të mbështesin kërkesën e studentëve për përmirësimin e kushteve të konvikteve, duke e adresuar këtë problematikë në institucionet përkatëse.
10. Të mbështesin kërkesën për pajisjen me kartën e studentit dhe pas daljes së akteve nënligjore përkatëse, UMT të marrë masa të menjëhershme për realizimin e kësaj kërkesë.

Mbi përfaqësimin e studentëve në organet kolegjiale të UMT-së:

11. Rritja e përfaqësisë së studentëve në Senatin Akademik të UMT-së nuk është në kompetencë të këtij organi.
12. Përfaqësimi i studentëve në Bordin e Administrimit nuk është në kompetencë të Senatit Akademik.
13. Shkarkimi i përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik bëhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për humbjen e mandateve nga persona të zgjedhur, nuk është në kompetencë të Senatit Akademik.

Lidhur me aspektin akademik:

14. Të mbështesin kërkesën e studentëve për hapjen e programeve të reja të studimit, propozime këto që vijnë nga Departamentet dhe Dekanatet përkatëse në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kërkesat e tregut të punës dhe analizës financiare të tyre.
15. Të kërkojnë marrjen e masave të duhura nga dekanatet, që Portali i Studentëve të bëhet funksional brenda 3 muajve.
16. Të miratojnë kërkesën, që në raste të veçanta, me kërkesë të Këshillit Studentor të fakultetit përkatës mund të hapet sezoni i provimeve në muajin nëntor.

17. Të miratojnë numrin e provimeve për përmirësim (rishikim) deri në 2 lëndë në vit.
18. Të mos miratojnë ndalimin e transferimeve nga IAL jopublike në UMT, sepse nuk është në përputhje me Parimet e Kartës së Bolonjës.
19. Rishikimi i fondit të pyetjeve për provimin/et e licencës nuk është në kompetencë të Senatit Akademik. Kjo kërkesë duhet ti adresohet UMSH.
20. Të ngarkojnë dekanatet përkatëse për bërjen transparente të procedurës së kontrollit të dijeve, mënyrës së zhvillimit të provimeve, si dhe procedurën e ankimimit të provimeve për çdo lëndë.
21. Të ngarkojnë dekanatet për informimin dhe publikimin e procedurës dhe udhëzimit për realizimin e temave të diplomave. Dekanatet kanë detyrimin për informimin e studentëve me temat e diplomave në fillim të vitit të parafundit akademik të studimeve.
22. Të kërkojnë që departamentet dhe dekanatet, të paraqesin propozimet për listën e teksteve, si dhe fondin përkatës për bërjen e tyre. Fakultetet të evidentojnë dhe plotësojnë nevojat për shtimin e sallave të leximit.
23. Të mbështesin propozimet e studentëve për përmirësim të infrastrukturës në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të ngarkojnë dekanatet për parashikimin e fondeve përkatëse në buxhetin e vitit 2019.
24. Të ngrihen grupe pune për evidentimin e problematikave të teksteve mësimore, si dhe zgjidhjen konkrete të tyre.
25. Nuk përkrahën kërkesën e studentëve për uljen e kufirit minimal (me 10 kredite) të kalimit në vitin pasardhës, sepse kjo do të cënonte rëndë cilësinë akademike.
26. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në përputhje me misionin dhe objektivat e saj, të raportojë çdo tre muaj pranë Senatit Akademik, mbi vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik, që kryhet nëpërmjet pyetësorëve të studentëve.
27. Të përkrahin denoncimet e rasteve të korrupsionit të pedagogëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
28. Lidhur me kërkesën për nivelin e gjuhës së huaj, kriter në hyrje për studentët specializantë, rikonfirmojmë përcaktimet në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e mjekësisë, neni 72, miratuar me Vendim nr. 88, datë 16.11.2016 të Senatit Akademik. Rektorati të rikërkojë pranë MASR që niveli i gjuhës së huaj për studentët specializantë të jetë B2 (dhe jo C1). Lidhur me qendrat e gjuhëve të huaja, nuk është në kompetencë të Senatit Akademik përcaktimi i tyre.
29. Realizimin e auditeve të aktivitetit akademik dhe financiar të Fakulteteve për 10 vitet e fundit dhe të UMT-së prej ditës të konstituimit të tij me synim evidentimin e problematikave dhe korrigjimin apo përmirësimin e tyre.
30. Ti kërkojnë Rektoratit, Dekanateve dhe Departamenteve të ngrënë grupe të përbashkëta pune me Këshillat Studentore përkatëse, për të analizuar dhe adresuar problematikat e ngritura, si dhe në

vazhdimësi, në mënyrë që ato të gjejnë zgjidhje dhe të reflektohen në dokumentet zyrtare të universitetit.

31. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamentet, Fakultetet, NJSBC, Drejtoritë e Rektoratit dhe Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

32. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT
ADRIANA BERBERI

Adriana Berberi



KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GJATA

Arben Gjata